



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



5.

Titulli - Prirja e MeDana			
09.02.2012			
Nr. i Organi Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednos
	01-013/141		

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 06.02.2012, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E PËRKOHSHËM FATIME RAMADANI

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, bënë caktimin dhe bartjen administrative të së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme (tokës) e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr 898-2, lloji i pronës parcelë, zona u/r Unknown, vendi i quajtur "FSHAT", në sipërfaqe prej 300m2 Zona Kadastrale Gërmovë, nga pronari i më parshëm pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal në Viti, në bartësin e ri shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani, në Viti.

Neni 2

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën me nr 07-16/84 të datës 18.01.2012 e znj. Fatime Ramadani drejtuar Drejtorisë për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë, obligohet që të bëjë ndërrimin në regjistrin kadastral në emër të shfrytëzuesit të ri Fatime Ramadani nga Vitia.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

01. Nr _____
Viti, 08.02.2012

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Fatime Ramadani
3. Arkivit

